

20160531355

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR INSPEKSION ADMINISTRATIV

Neni 1

Në Ligjin për inspeksion administrativ ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 69/04, 22/2007, 115/2007, 51/11, 164/13, 41/14, 33/15, 156/15 dhe 193/15), në nenin 5 paragrafi 1 në alinenë 5 numri "300" zëvendësohet me numrin "240".

Neni 2

Në nenin 7 paragrafi 3 pika 5 në alinenë 4 presja zëvendësohet me lidhëzën "ose".

Në alinenë 5, lidhëza "ose" zëvendësohet me lidhëzën "dhe".

Alineja 6 shlyhet.

Neni 3

Në nenin 10 në paragrafin 3 fjalët: "ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës" zëvendësohen me fjalët: "Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Shkallë të Dytë në Sferën e Mbikëqyrjes Inspektuese dhe Procedurës për Kundërvajtje".

Në paragrafin 5 fjalët: "Ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës" zëvendësohen me fjalët: "Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Shkallë të Dytë në Sferën e Mbikëqyrjes Inspektuese dhe Procedurës për Kundërvajtje".

Neni 4

Pas nenit 10 shtohet nen i ri 10-a si vijon:

"Neni 10-a

Nëse inspektori konstaton se mangësitë në punën administrative kanë ndodhur për shkak të numrit të madh të kërkesave të parashtruara, me ç'rast personat zyrtarë që veprojnë nuk mund t'i respektojnë afatet, inspektori me aktvendim urdhëron që funksionari i organit ose personi udhëheqës të ndërmarrë masa dhe aktivitete për sigurim të numrit të mjaftueshëm të personave zyrtarë që do të ndërmarrin veprime administrative, përkatësisht do të zgjidhin lëndë administrative dhe për atë do të caktojë afat jo më të gjatë se gjashtë muaj nga dita e pranimit të aktvendimit.

Funksionari i organit ose personi udhëheqës ku janë përcaktuar rastet nga paragrafi 1 i këtij neni, është i detyruar që në afatin e caktuar me aktvendim të ndërmarrë masa dhe aktivitete për sigurimin e numrit të mjaftueshëm të personave zyrtarë që do të ndërmarrin veprime administrative, përkatësisht do të zgjidhin lëndë administrative, dhe për atë ta njoftojë inspektorin.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 1 i këtij neni funksionari i organit ose personi udhëheqës, mund të parashtrorjë ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Shkallë të Dytë në Sferën e Mbikëqyrjes Inspektuese dhe Procedurës për Kundërvajtje në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Ankesa nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Shkallë të Dytë në Sferën e Mbikëqyrjes Inspektuese dhe Procedurës për Kundërvajtje miraton aktvendim në afat prej 15 ditësh nga dita e parashtrimit të ankesës."

Neni 5

Në nenin 18 në paragrafin 1 fjalët: "ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës" zëvendësohen me fjalët: "Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Shkallë të Dytë në Sferën e Mbikëqyrjes Inspektuese dhe Procedurës për Kundërvajtje".

Në paragrafin 3 fjalët: "Ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës" zëvendësohen me fjalët: "Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Shkallë të Dytë në sferën e Mbikëqyrjes Inspektuese dhe Procedurës për Kundërvajtje".

Neni 6

Në nenin 22 në paragrafin 1 pas alinesë 4 shtohet aline e re 5, si vijon:

"- në afatin e caktuar nuk e zbaton aktvendimin për mënjanimin e parregullsive të përcaktuara nga neni 10-a paragrafi 1 i këtij ligji,"

Neni 7

Procedurat e filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji do të përfundojnë në pajtim me ligjin sipas të cilit kanë filluar.

Neni 8

Dispozitat e neneve 3 dhe 5 të këtij ligji do të fillojnë së zbatuari me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, në pajtim me nenin 141 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/15).

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".